

**Vendim nr. 85, datë 11.03.2026**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari, Kryesuese

Illir Toska, Anëtar

Genti Ibrahim, Anëtar

në datën 11.03.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 4 (I) 2026 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** **IRAKLI GAJO**, përfaqësuar nga avokat Agron Tozaj, me prokurë të posaçme.

**OBJEKTI:** **Shfuqizimi i vendimeve nr. 26, datë 03.03.2022 të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr. 00-2025-1083, datë 01.07.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Konventën Evropiane për të Drejtat Njeriut.**

**Njohja e shkeljes të së drejtës së pronës për shkak të mosveprimit/dështimit të autoriteteve për të zhvilluar procedime penale të drejta.**

**Detyrimi i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për të përsëritur gjykimin.**

**BAZA LIGJORE:** **Nenet 41, 42, 131 dhe 134 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 49, 50 dhe 51 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për**

**organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (Ligji Organik i Gjykatës).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I**

**Rrethanat e çështjes**

1. Në datën 27.07.2016 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë ka regjistruar procedimin penal nr. 1414/2016 për veprën penale të falsifikimit të dokumenteve, të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal (*KP*), mbi bazën e kallëzimit të paraqitur nga i ati i kërkuarit. Fakti penal i kallëzuar lidhet me dokumentin “Akt njoftimi zotërimi”, datë 13.12.1954, i lëshuar nga Gjykata e Nënprefekturës Popullore Vlorë në emër të një personi të tretë. Ky dokument ishte përdorur si provë në një proces gjyqësor civil të zhvilluar gjatë viteve 2010-2015, me objekt njohjen e pronësisë mbi një pasuri të paluajtshme, e cila ishte regjistruar më parë në emër të kallëzuesit. Në përfundim të këtij procesi, gjykatat e zakonshme kanë vendosur njohjen e së drejtës së pronësisë dhe kthimin e pasurisë në favor të trashëgimtarëve të personit të tretë. Si pasojë e kësaj vendimmarrjeje, i ati i kërkuarit ka humbur të drejtën e pronësisë mbi një truall me sipërfaqe 203 m<sup>2</sup>, të ndodhur në Vlorë.

2. Në lidhje me kallëzimin e paraqitur, në përfundim të hetimeve paraprake, me kërkesë të prokurorit për pushimin e procedimit penal, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 203, datë 12.02.2018, ka vendosur pranimin e kërkesës dhe pushimin e procedimit penal. Mbi bazën e ankimit të kërkuarit, në cilësinë e trashëgimtarit ligjor të kallëzuesit, Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 227, datë 10.04.2018, ka vendosur prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në gjykatën e shkallës së parë, për shkakun se në gjykim nuk ishin thirrur për të marrë pjesë personat e kallëzuar.

3. Në rigjykim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 1085, datë 24.10.2018, ka vendosur sërish pranimin e kërkesës së prokurorit për pushimin e procedimit penal, me argumentin se nuk provohej kryerja e veprës penale. Në vijim, Gjykata e Apelit Vlorë, me

vendimin nr. 118, datë 21.02.2019, ka vendosur prishjen e vendimit, rrezimin e kërkesës së prokurorisë për pushimin e procedimit penal dhe kthimin e akteve asaj për vazhdimin e hetimeve, duke i lënë disa detyra për hetime të mëtejshme.

4. Pas kryerjes së disa veprimeve hetimore shtesë, prokurori i është drejtuar sërish gjykatës për pushimin e procedimit penal, me argumentin se, në mungesë të dokumentit origjinal, nga ekspertimi teknik nuk mund të konkludohej për falsitetin e tij. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 431, datë 23.12.2020, ka vendosur përsëri pranimin e kërkesës së prokurorit dhe pushimin e procedimit penal, me arsyetimin se fakti penal nuk provohej dhe se ndjekja penale ishte parashkruar. Ndonëse kërkuesi ka paraqitur ankim, vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 26, datë 03.03.2022, ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-1083, datë 01.07.2025, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit.

5. Në datën 16.01.2026 kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), sipas objektit. Ankimi, pasi është plotësuar në përputhje me parashikimet e Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 23.01.2026.

## II

### Pretendimet e kërkuesit

6. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se nga vendimet gjyqësore të kundërshtuara i janë cenuar:

6.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të parimit të sigurisë juridike dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi prokurori dhe gjykata e shkallës së parë nuk kanë zbatuar në thelb vendimin përfundimtar nr. 118, datë 21.02.2019 të Gjykatës së Apelit Vlorë, i cili kishte urdhëruar zhvillimin e një hetimi të plotë dhe vlerësimin substancial të elementeve të dyshuara të falsifikimit. Ndonëse janë kryer disa veprime hetimore, procedimi është pushuar duke riprodhuar përfundimet e mëparshme, pa u zbatuar udhëzimet detyruese të vendimit për rigjykim, duke sjellë si pasojë mbrojtje gjyqësore teorike dhe jo efektive. Po ashtu, gjykatat nuk kanë dhënë përgjigje të plotë pretendimeve thelbësore për ekzistencën e falsifikimit, veçanërisht atyre që lidhen me mungesën e dokumentit në arkivat shtetërore, mospërputhjet historike dhe juridike, si dhe raportin

e tij me dokumentet arkivore të mëvonshme, duke pamundësuar kështu kontrollin efektiv gjyqësor dhe ushtrimin real të së drejtës së ankimit. Në vendimet e kundërshtuara, gjykatat, duke u mbështetur në dispozita të ndryshme të nenit 328 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), kanë arritur në përfundime kontradiktore për shkaqet e pushimit të procedimit penal, pra nëse në rastin konkret ka ekzistuar një shkak pengues për ndjekjen penale, nëse ka munguar prova e autorësisë ose nëse ka munguar fakti penal. Kjo mënyrë arsyetimi tregon mungesë koherence në hetim dhe në kontrollin gjyqësor, si dhe karakterin formal dhe arbitrar të vendimmarrjes.

6.2. *E drejta e pronës*, e garantuar nga neni 41 i Kushtetutës dhe nga neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, pasi zhvillimi i një hetimi penal joefektiv lidhur me autenticitetin e dokumentit të dyshuar si i falsifikuar ka bërë të mundur përdorimin e tij në procedura civile dhe administrative, duke çuar në çregjistrimin e një pjese të pasurisë së kërkuesit. Ndërhyrja në të drejtën e pronës nuk ka ardhur si rezultat i një akti të drejtpërdrejtë të autoriteteve shtetërore, por si pasojë e përdorimit, nga subjekte private, të një dokumenti të dyshuar si i falsifikuar, gjë që për kërkuesin ka sjellë humbjen e pronës. Gëzimi paqësor i pronës përfshin edhe detyrime pozitive për shtetin, për të garantuar mbrojtje efektive përmes një kuadri ligjor dhe mekanizmash proceduralë të përshtatshëm. Në këtë drejtim, moszbatimi në themel i detyrave të përcaktuara nga gjykata e apelit në vendimin e rigjyimit të çështjes, mungesa e një analize të pavarur mbi natyrën dhe origjinën e dokumentit të kontestuar, si dhe arsyetimi formal dhe i përgjithshëm i vendimeve përfundimtare kanë bërë që sistemi penal të mos shërbejë si një mjet efektiv mbrojtjeje për interesat pronësorë të kërkuesit.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimitimin e kërkuesit

7. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe

2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

8. Kolegji çmon se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial, pasi jo vetëm ka qenë palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, por justifikon edhe interesin material për vënien në lëvizje të gjyimit kushtetues. Në këtë drejtim, Kolegji vë në dukje se kërkuesi kundërshton vendimet e dhëna në procesin gjyqësor për pushimin e procedimit penal në lidhje me veprën penale të falsifikimit të dokumenteve, proces i cili, në rast të një rezultati të ndryshëm, mund të ndikonte, sipas ligjit procedural civil, në rishikimin e procesit gjyqësor civil, në përfundim të të cilit ai, në cilësinë e trashëgimtarit, ka humbur të drejtën e pronësisë mbi truallin me sipërfaqe 203 m<sup>2</sup>.

9. Për sa i takon *kriterit të shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion*, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual për kundërshtimin e vendimeve të gjykatave të zakonshme, përfshirë edhe vendimin e Gjykatës së Lartë, që ka përmbyllur procesin gjyqësor për pushimin e procedimit penal. Po ashtu, ai i ka ngritur në thelb pretendimet e tij në aktet e apelit dhe të rekursit. Për rrjedhojë, Kolegji, bazuar në nenin 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, çmon se kërkuesi e ka përmbushur edhe kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive.

10. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit Organik të Gjykatës. Vendimi i Gjykatës së Lartë, që ka përmbyllur procesin gjyqësor të kundërshtuar, është dhënë në datën 01.07.2025 dhe është publikuar në faqen zyrtare të internetit të asaj gjykate në datën 24.09.2025, ndërsa ankimi është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 16.01.2026, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

11. Në drejtim të legjitimitetit *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar se vendimet e Gjykatës së Apelit Vlorë dhe të Gjykatës së Lartë i kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor në aspektet e parimit të sigurisë juridike dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, si

dhe të drejtën e pronës. Këto të drejta garantohen, përkatësisht, nga nenet 42 dhe 41 të Kushtetutës dhe, për rrjedhojë, *prima facie* hyjnë në juridiksionin kushtetues, ndaj do të analizohen në vijim.

12. Kolegji vëren se kërkuesi, për të argumentuar pretendimet e tij, ka parashtruar se dokumenti bazë ku mbështeten të gjitha vendimet që kanë prodhuar titullin e pronësisë në favor të një personi të tretë është “Akt njoftuni zotërimi”, i lëshuar në datën 13.12.1954 nga Gjykata e Nënprefekturës Popullore Vlorë, i cili, sipas tij, është një dokument tërësisht i falsifikuar. Sipas kërkuetit, nuk është zhvilluar një hetim penal efektiv në lidhje me falsifikimin e këtij dokumenti zyrtar, i cili, duke u përdorur si provë në procesin civil, ka passjellë humbjen e një pjese të pasurisë së tij. Gjithashtu, sipas kërkuetit, gjykata e apelit në vitin 2019 ka konstatuar nevojën për hetime të mëtejshme, duke lënë detyra specifike, të cilat nuk u respektuan në vijim as nga prokuroria, as nga gjykata që pranoi kërkesën e prokurorit për pushimin e procedimit penal. Moszbatimi i detyrave të përcaktuara në një vendim gjyqësor përfundimtar, mungesa e analizës së pavarur mbi natyrën dhe origjinën e dokumentit të kontestuar, si dhe arsyetimi formal i vendimeve gjyqësore, jo vetëm shkelin të drejtën për proces të rregullt ligjor, por tregojnë, sipas kërkuetit, edhe se sistemi penal nuk ka shërbyer si mjet efektiv mbrojtjeje për interesat e tij pronësorë. Për pasojë, sipas tij, nuk janë përmbushur detyrimet pozitive të shtetit për gëzimin paqësor të pronës, që rrjedhin nga neni 41 i Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

13. Duke mbajtur në konsideratë thelbin e pretendimeve të kërkuetit, që lidhet me vlerësimin e gjykatave të zakonshme për sa u përket veprimeve hetimore të kryera, të cilat, sipas tij, kanë ndikuar në të drejtën e pronës (*shih paragrafin 12 të vendimit*), Kolegji çmon ta analizojë çështjen e paraqitur në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës, sipas të cilit prona nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pronës, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë.

14. Gjykata ka pohuar se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e kësaj Gjykate është të shqyrtojë dhe vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 3, datë 23.02.2016; nr. 42, datë 07.07.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Në kuptim të gjykimit të drejtë, Gjykata ka pranuar se ajo nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ndërhyt atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat

e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Elementi thelbësor i një vendimi të drejtë është arsyetimi, i cili u tregon palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Detyrimi për arsyetim ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit (*shih vendimet nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 6, datë 16.02.2021; nr. 79, datë 14.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Arsyetimi i kufizuar i vendimeve të mospranimit të rekursit nga Gjykata e Lartë nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, përderisa në thelb shpreh shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj gjatë shqyrtimit paraprak të tij në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 21, datë 16.04.2015; nr. 37, datë 19.09.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Mbi bazën e këtyre standardeve, Kolegji vëren se, sikurse parashtrohet kërkuesi, Gjykata e Apelit Vlorë në vitin 2019 ka urdhëruar prokurorinë të kryejë veprime të mëtejshme hetimore, vendim ky që nuk është kundërshtuar me recurs. Megjithatë, në ndryshim nga sa argumenton kërkuesi, prokurori ka paraqitur sërish në gjykatë kërkesë për pushimin e procedimit penal vetëm pas kryerjes së veprimeve hetimore shtesë. Në vijim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin e datës 23.12.2020, mbi bazën e veprimeve të kryera dhe pas analizës së elementeve objektive dhe subjektive të veprës penale, ka arritur në përfundimin se nuk mund të provohej tej çdo dyshimi të arsyeshëm as ekzistenca e faktit penal dhe as autorësia e tij, ndaj, në bazë të nenit 328, pika 1, shkronja “a”, të KPP-së, duhej vendosur pushimi i procedimit penal.

17. Më pas, gjykata e apelit, me vendimin e datës 03.03.2022, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke evidentuar me detaje veprimet hetimore të kryera nga prokurori, në zbatim të detyrave të lëna prej saj në vendimin e vitit 2019 dhe konkretisht: (i) kryerjen e ekspertimit topografik të pronës për të përcaktuar sipërfaqen e truallit që zotëronte personi i tretë sipas dokumentit të pretenduar si i falsifikuar (sipas aktit të ekspertimit topografik të datës 20.01.2020, eksperti, pasi ka verifikuar aktet përkatëse, ka arritur në përfundimin se kufijtë e pronës dhe sipërfaqja e truallit nuk mund të përcaktoheshin, për shkak të mungesës së të dhënave teknike në akte dhe pasaktësive të tyre); (ii) kryerjen e ekspertimit teknik grafik për të përcaktuar nëse në “Aktin e njoftunisë së zotënimit” kishte ndërhyrje falsifikuese, shtesa, ndryshime ose korrigjime (sipas aktit të ekspertimit grafik të datës 20.11.2019, të kryer nga Instituti i Policisë Shkencore, në gjendjen që paraqitej dokumenti, pra si fotokopje, nuk mund të nxirreshin

konkluzione); (iii) verifikimin nëse dokumenti “Akt njoftuni zotënimi” ishte noterizuar ose jo në zyrën e noterit (sipas veprimit të realizuar nga Policia Gjyqësore në datën 05.07.2019, për këqyrjen e regjistrit të noterit, ka rezultuar se në të pasqyrohej veprimi noterial i datës 15.05.2009, me përshkrimin “njësim me origjinalin i dokumentit vendim gjykate”, dokumentuar edhe përmes marrjes, në cilësinë e provave materiale, të fletëve të regjistrit noterial). Mbi bazën e këtyre veprimeve shtesë, të vlerësuara edhe me faktet e mëparshme të procedimit penal, Gjykata e Apelit Vlorë ka arritur në përfundimin se prokurori kishte kryer në mënyrë të plotë dhe shteruese të gjitha veprimet hetimore të mundshme për t’u dhënë përgjigje pretendimeve të parashtruara në kallëzim. Sipas asaj gjykate, pas kthimit të çështjes për hetime të mëtejshme në vitin 2019 dhe zbatimit të detyrave të caktuara, prokurori ka kryer në mënyrë korrekte veprimet hetimore të mundshme, duke bërë një analizë racionale të të dhënave hetimore. Për këto arsye, ajo gjykatë ka vlerësuar se nuk mund të provohej tej çdo dyshimi të arsyeshëm ekzistenca e faktit penal dhe autorësia e veprës penale, ndaj vendimi gjyqësor për pushimin e procedimit penal duhej të lihej në fuqi.

18. Gjykata e Lartë, me vendimin e datës 01.07.2025, të marrë në dhomën e këshillimit, në fazën e shqyrtimit paraprak, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, duke vënë në dukje se gjykatat e faktit i kanë dhënë përgjigje të argumentuara të gjitha pretendimeve të tij dhe se prokuroria kishte kryer të gjitha veprimet hetimore të mundshme.

19. Nga sa më lart, Kolegji vlerëson se gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë kanë marrë në shqyrtim thelbin e kërkimeve dhe pretendimeve të kërkuesit dhe kanë arsyetuar mjaftueshëm në lidhje me qëndrimin e shprehur në dispozitiv. Në veçanti, gjykata e apelit ka evidentuar veprimet hetimore shtesë të kryera nga prokuroria në përmbushje të detyrave të lëna prej saj me vendimin e vitit 2019 dhe, mbi bazën edhe të këtyre veprimeve, ka arritur në përfundimin nuk mund të provohej tej çdo dyshimi të arsyeshëm ekzistenca e faktit penal dhe autorësia e veprës penale të kallëzuar. Po kështu, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se gjykatat e faktit u kishin dhënë përgjigje të argumentuar pretendimeve të ngritura nga kërkuesi dhe se nuk ekzistonin shkaqe ligjore që t’i bënin të cenueshme vendimmarrjet e tyre. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se vendimet e kundërshtuara nuk mbështeten në një arsyetim formal ose të pamjaftueshëm dhe as përmbajnë gabime të dukshme faktike ose ligjore që do t’i bënin ato arbitrare. Në këto kushte, pretendimet e kërkuesit për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në aspektet e parimit të sigurisë juridike dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, për pasojë edhe të së drejtës së pronës janë haptazi të pabazuara.

20. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

**PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

**V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.